

PROJEKT – REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SE ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TE DREJTËSISË PËR VITIN 2022

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadër të inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë;

Bazuar në analizën e të dhënave të referuara në raportin e paraqitur për vitin 2022, Kuvendi i Shqipërisë konstaton se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka:

- Ulur numrin e ankesave të patrajuara të dorëzuara nga organet e mëparshme gjatë periudhës kalimtare.
- Hartuar dhe miratuar raporte të detajuara vjetore dhe periodike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë lidhur me aktivitetin e institucionit.
- Është angazhuar në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale në zbatim të nenit 204, pika “c” e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".
- Shqyrtuar 1715 ankesa dhe ka marrë 28 vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor për 41 subjekte të hetimit disiplinor.
- Hartuar dhe miratuar 22 urdhra të përgjithshëm me karakter administrativ për organizimin, funksionimin, menaxhimin dhe kontrollin financiar në institucion.

- Përfunduar 2 inspektive tematike të iniciuara gjatë vitit 2021 me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar, dhe “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”.
- Bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtar.
- Nënshkruar tre memorandume bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtar.
- Organizuar konferencë ndërkombëtare me homologë të vendeve të BE-së, anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë e të tjerë, si dhe profesionistë të spikatur të së drejtës, rreth temës “Interesi i publikut dhe pavarësia e magistratëve”.
- Marrë pjesë në një numër konferencash shkencore duke përfutur eksperiencë.
- Është angazhuar në ndërveprim me qytetarët nëpërmjet informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes në internet, etj.

Kuvendi i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2023, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

1. Përmbysjen brenda vitit 2023 të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare.
2. Fillimin sa më shpejt të vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve në funksion të kryerjes së kontrollit të brendshëm periodik.
3. Vijimin me ritme të shpejta të zhvillimit të sistemit të teknologjisë së informacionit dhe strategjisë së menaxhimit të rasteve, në përmbushje të detyrimeve ligjore.
4. Vijimin dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
5. Forcimin e mekanizmave institucionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor.
6. Rritjen e kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet implementimit të eksperiencave dhe përvojave më të mira të institucioneve të huaja me të njëjtën fushë veprimi, me fokus përmirësimin e procesit të punës në trajtimin e ankesave, proceseve hetimore etj.
7. Bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm për përcaktimin e çështjeve për inspektimet tematike me synim rekomandimin për standartet e njëjta në proceset hetimore dhe gjyqësore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, barazisë para ligjit dhe parimit të proporcionalitetit.

Miraturar në _____